



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 13.2.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10 dhe N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Daut Haradinaj, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH dhe ministri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 7.02.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbeturina,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime. Për disa çështje tjera urgjente komisioni u pajtua që të shqyrtohen siç janë : Agjencia e rrezatimeve dhe raporti i kontaminimit nga projekti EULUP.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7.2.2012.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Agjencinë e Rrezatimeve

Kryetari Nait Hasani përshëndeti ministrin e MMPH dhe njoftoi për ecurinë e punës së Komisionit rreth projektligjit duke sqaruar se zyrtarët nga Ambasada e Amerikës kanë sugjeruar që ky agjenci duhet të jetë pranë ZK (zyrës së Kryeministrit) në bazë së cilës bisedë janë sugjeruar amendamentet ekzistuese. **Ministri Dardan Gashi** tha se nuk insiston asgjë por ministria është i orientuar lidhur me këtë agjenci në MMPH, ndërkaq lidhur me këtë sugjerim nuk kanë pasur bisedë me Kryeministrin. Në Komisionin për Buxhet është thënë se kjo agjenci gradualisht duhet të pavarësohet por fillimisht e ka vendin në MMPH, si dhe transferimi i administratës në Qeveri përkatësisht në ZK nuk do të ishte punë aq e thjeshtë (kryeshefi me dy puntorë, të cilët janë transferua nga departamenti i mjedisit) ngase MMPH-së edhe ashtu i mungon stafi. Nëse kalon agjencia në ZK duhet atje prapë të krijohen institucionet mbështetëse siç janë Inspektorati etj. Ai shtoi se BE nuk ka caktuar ku duhet të ketë vendin kjo agjenci. Pasi që buxheti nuk është parapa për Agjenci, ai shtoi se duhet të bëhen konsultimet shitesë ngase buxheti është i MMPH sa i përket agjencisë në fjalë. **Salih Morina** insistoi të kthehet edhe një herë projektligji në Qeveri dhe të kompletohet si duhet. **Liburn Aliu** rikujtoi se në mbledhjen e përbashkët me komisionin për buxhet ka pasur mendime të ndara ku duhet ta ketë vendin agjencia, disa ishin të mendimit që kjo agjenci duhet të zhvillohet pastaj të pavarësohet, disa tjerë të kundërtën : duhet të pavarësohet për tu zhvilluar. Ai mbrojti mendimin se agjencia duhet të zhvillohet fillimisht ngase nuk ka potencialin për tu pavarësuar, pra të mbetet pranë MMPH. Nuk mohoi se agjencia e ka emrin e madh, por ajo duhet ti bëjë edhe disa vite përvojë për tu pavarësuar. **Afërdita Berisha** përkrahu mendimin se kjo agjenci do të ishte më mirë të ishte pranë MMPH ngase aty do të ketë më tepër shanse për donacione dhe më tutje të zgjerohet. **Ferki Fejza** kërkoi mirëkuptim ngase nuk është fjala për dëshirën e tij personale si kryeshef por kemi të bëjmë me një institucion me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Agjencia duhet të jetë pranë ZK ngase është standard ndërkombëtar që kërkohet dhe është në interes të vendit, Ligji në fuqi për rrezatime mbron këtë tezë për të krijuar dokumentin bazik për një vendim marrje të pavarur. **Liburn Aliu** konstatoi se miqtë duhet ti dëgjojmë por ne ti sjellim vendimet, ai tha se dallohet prej disa diskutuesve vetëm sa i përket një çështjeje jo aq qenësore dmth edhe ai kërkon pavarësi për këtë organ por pas një kohe, dhe pyeti pse kemi nevojë të shtyjme këtë çështje. **Nijazi Idrizi** konstatoi se agjenci të pavarur në kuptimin e plotë nuk ka, ngase secila varet nga dikush, ndërsa sa i përket pyetjes pranë cilit organ duhet të jetë, ai u fokusua pranë ZK ngase aty do të kishte mundësitë dhe kapacitetet më të mëdha për tu zhvilluar. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Përafërsisht pas një jave të ftohet prapë ministri i MMPH në mbledhjen e komisionit ku do të sqarohen bisedat e MMPH me ZK që do të zhvillohen në ndërkohë, rreth Projektligjit për Agjencinë në fjalë.

4. Raporti i EULUP për kontaminimin e tokës bujqësore

Nait Hasani konstatoi se lidhur me këtë raport për mbledhjen e sotme janë ftuar zyrtarët e MB bashkë me ministrin, por të njëjtit për shkak të kohës së keqe përkatësisht mungesës së ministrit, nuk kanë pasur mundësi të prezantojnë. Ai rikujtoi komisionin se gjatë monitorimit të Ligjit për tokën bujqësore është konstatuar ndotja e tokës bujqësore por askund nuk është thënë se është e helmuar kjo tokë, ndaj raporti në fjalë dhe shkrimet në media sipas tij janë të paqëndrueshëm dhe të dëmshëm për bujqësinë tonë. Ai sugjeroi të ftohet ministri në mbledhjen e radhës ngase bashkërisht duhet të konstatohet a duhet kërkuar mjete shitesë nga mbledhja plenare për një ekspertizë për të vërtetuar se a qëndrojnë elementet e cekura në atë raport. **Nijazi Idrizi** konstatoi pafajësinë e medieve ngase ata vetëm kanë paraqitë raportin si është, në fakt hulumtimi është shqetësues, përfundoi. **Nait Hasani** tha se ka elemente fajësie ngase kemi p.sh. në gazetën e 6

shkurtit titullin e shkruar ...”toka e helmuar”. **Salih Morina** lidhur me mjete financiare tha se ato duhet ti kërkoj Qeveria dhe të vërtetoi faktet, jo Kuvendi. **Afërdita Berisha** shtoi se raporti duhet të cekë cila pjesë e Kosovës është me tokë të helmuar dhe si ka ardhur tek ajo. **Salih Morina** përmendi Rahovecin dhe Malishevën me disa licenca të lëshuara nga Agjencia për miniera, ndaj ato duhet të hulumtohen si dhe arsyet pse janë lëshuar. **Liburn Aliu** konstatoi se të gjithë për afërsisht e dinë se në Kosovë ka ndotje dhe Qeveria nuk ka mjete për të ndal këtë dukuri të degradimit të tokës bujqësore, mirëpo ai u fokusua për një tryzni të përbashkët që duhet bërë Qeverisë, në mënyrë që ajo të kujdeset për Miniera të cilat duhet të plotësojnë kriteret e duhura. Në kuadër të kësaj fushate, **Salih Morina** ceku propagandën për disa perime të cilat nuk duhet të mbjellën në Kosovë, ndaj tha se për këtë është dashur të kujdeset Qeveria. Ai kërkoj që në mbledhjen ku do të ftohet ministri i bujqësisë duhet të ftohet edhe ai i mjedisit ngase ngërthehen edhe çështjet mjedisore.

Nait Hasani konstatoi se ministri i bujqësisë nuk është në Kosovë deri të enjten, kurse ai i mjedisit deri më 27 shkurt nuk është në Kosovë, ndaj në ndërkohë do të bëhen konsultimet për një takim me dy ministrat, ashtu si u kërkuar në mbledhje.

5. Projektligji për Mbeturina

Nait Hasani falënderoi pjesëmarrësit që marin pjesë lidhur me këtë projektligj për të cilin fillimisht sqaroi në hollësi kush deri tani ka bërë vërejtje për përmirësime në të. Ai gjithashtu falënderoi edhe Ekspertin Behxhet Shala i cili ka propozuar komisionit 38 amendamente për 84 nene të Projektligjit.

Në vazhdim, përmes monitorit komisioni debatoi për amendamentet e ekspertit dhe arriti deri te Amendamenti 5 duke bërë sqarime dhe përmirësime të duhura. Evidentimi i vërejtjeve janë shënuar përmes monitorit, ndërkaq puna e komisionit rreth tyre do të vazhdoi nesër më 14.2.2012 në orën 13,00.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani